



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 05.08.25		
Priljeno: 2025		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-40815		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 05.08.2025

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren, MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, (KLUBET SPORTIVE, kategoritë : Futboll, volejboll dhe Hendboll) me Seli në Komunën e Lipjanit që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në lëminë e SPORTIT në Komunën e Lipjanit.

Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE Kategoritë: Futboll,volejboll dhe Hendboll) të regjistruara, të cilat kanë seli në Komunën e Lipjanit dhe bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse për kategoritë e Seniorëve. OJQ-të (KLUBET SPORTIVE Kategoritë: Futboll, volejboll dhe Hendboll) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e sportit dhe rekreacionit.

Organizatat jo-qeveritare (KLUBET SPORTIVE Kategoritë: Futboll, volejboll dhe Hendboll) mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në Sport dhe aktivitetet SPORTIVE në Komunën e Lipjanit.

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 70.000,00 euro.

Mjetet do të tërhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 15.000,00 euro.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 25.08.2025.

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për gjashtë (6) muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (KLUBET SPORTIVE Kategoritë: Futboll,volejbolll dhe Hendboll) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

Klubet aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. KLUBET SPORTIVE, Kategoritë: Futboll,volejbolll dhe Hendboll duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, KLUBI duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se KLUBI, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: uran.qeriqi@rks-gov.net

Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së

